



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:015803

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05522701

C.nr.184/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështjen juridike kontestimore të inicuar me padi nga ana e paditësit S.Z. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës, me vlerë të kontestit 328 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **29 mars 2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.Z. nga Prizreni.

II. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të shujtave ditore për **ditë 164** pune gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2022, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **328.00 (treqind e njëzetetë) euro**, me kamatë ligjore prej 8% të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. **DETYROHET** e paditura që paditësit S.Z. nga Prizreni, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 125 (njëqind e njëzet e pesë) euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi S.Z. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. M.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 18.01.2023, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i shujtave ditore, me vlerë të kontestit 328.00 euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi në cilësinë e mësimdhënësit në institucionin arsimor SHMLP "Ymer Prizreni" në Prizren, nuk ka

pranuar mjetet e parapara për kompensimin e ushqimit (shujtave) në punë dhe atë në vlerë prej 2 euro në ditë të shpenzimeve siç parashihet me nenin 35 para. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e vitit 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 22.01.2021 nenit 35 par.7. Padiësi gjatë vitit 2022 ka qenë i pranishëm në punë për 164 ditë, nga data 06.01.2022, i njëjti iu është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e shujtës por nuk ka marr përgjigje, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e padiësit dhe të obligohet e paditura në përmbushjen e detyrimit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 21 euro apo shumë e përgjithshme prej 125.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e padiësës. Ka theksuar se duke u bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022 për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2022 padia dhe kërkesëpadia e padiësës është e pabazuar. Ka theksuar se padiësja nuk ka ofruar prova që është anëtare e sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veproj në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Po ashtu ka theksuar se pretendimet e padiësës janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e padiësës. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e padiësës është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se padiësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në SHMLP "Ymer Prizreni" në Prizren, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Nga vërtetimi me numër të referencës48/1, të datës 10.01.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se padiësi S.Z. gjatë vitit 2022, ka qenë prezent në punë për 164 ditë pune.

Nga leximi i kërkesës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i'u është drejtuar Komunës së Prizrenit-Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e shujtave.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si mësimdhënës t'ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësen, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për 185 ditë prezent në punë, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 19.09.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës

Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 (njëqind e katër) euro për përpilimin e padisë, , si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 21.00 (njëzet) euro, gjithsej shumë prej 125.00 (njëqind e njëzet e katër) euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.184/23, me datë 29 mars 2024

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.